



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Nr. i Dokumentit: 22.2.1-2017-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË
DEÇANIT
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2017

Prishtinë, maj 2018

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikatat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Deçanit në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm, Valbon Bytyqi, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Ilir Abazi, Udhëheqës i Ekipit të Auditimit, dhe Arben Hundozi – Anëtar i Ekipit, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Mujë Gashi.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	11
4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	24
5 Qeverisja e mirë.....	25
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA	29
Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të dy viteve paraprake.....	32
Shtojca III: Letër konfirmimi	40

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky Raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore të Komunës së Deçanit për vitin 2017, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2017 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 16/11/2017.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Puna e ndërmarrë nga Zyra e Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2017 është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Komunës së Deçanit.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson Menaxhmentin dhe stafin e komunës, për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2017 *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.

Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se pasuritë dhe obligimet nuk ishin shpalosur në mënyrë të drejtë në pasqyrat financiare vjetore.

Më gjerësisht shih Pjesën 2.1 të këtij Raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore**Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2017**

Kryetari është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresoj të gjitha rekomandimet e dhëna.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Hyrje

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, si dhe dhënien e opinionit:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut për auditimin e Komunës së Deçanit. Ne kemi analizuar veprimtarinë e Komunës se deri në çfarë mase mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë që mbështesin opinionin e Auditorit të Përgjithshëm.

Seksionet e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të gjetjeve tona të auditimit, me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Përgjigjet e Menaxhmentit ndaj gjetjeve tona mund të gjenden në Shtojcën III.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Hyrje

Auditimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Gjithashtu merret parasysh edhe deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave (MF).

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

2.1 Opinioni i auditimit

Opinioni i pamodifikuar me theksim të çështjes

Ne kemi audituar PFV-të e Komunës së Deçanit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, shpalosjet dhe raportet tjera përcjellëse.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit të bazuar në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj, për faktin se shpalesjet për regjistrin e pasurive kapitale dhe obligimeve të papaguara në pasqyra financiare vjetore nuk ishin plotësisht të sakta, për shkak të çështjeve të identifikuara si në vijim:

- Prona komunale dhe pagesat për investime kapitale në vlerë 179,661€ nuk janë regjistruar në regjistrin kontabël të SIMFK-së. Për pasurinë jokapitale nuk është llogaritur zhvlerësimi vjetor dhe zhvlerësimi i akumuluar, ndërsa pasuria e blerë para vitit 2010 nuk është regjistruar në programin e-pasuria. Në regjistrin kontabël të pasurisë ende ekziston objekti arsimor në Komunën e Junikut, në vlerë neto 185,009€. Kjo reflekton pasaktësi në regjistrin e pasurisë dhe shpalesje të pasaktë të tyre në PVF-të e vitit 2017.
- Obligimet e papaguara janë nënvlerësuar për 28,950€, si rezultat i mos harmonizimit për të siguruar të dhëna të sakta në mes raportit të obligimeve të papaguara dhe shpalesjeve në pasqyra financiare vjetore.

Opinioni jonë nuk është kualifikuar për këtë çështje.

Çështjet kyçe të auditimit

Si rezultat i vendimeve gjyqësore dhe procedurave të përmbartimit, Ministria e Financave/Thesari, nga buxheti i Komunës së Deçanit ka certifikuar pagesa në vlerë totale 1,340,397€ për kryerjen e obligimeve ndaj operatorëve ekonomik. Sipas PVF-ve, në fund të vitit 2017 obligimet e papaguara në total ishin 420,380€, përfshirë edhe detyrimet kontingjente. Komuna është e ekspozuar edhe ndaj detyrimeve kontingjente apo kontesteve të borxheve, dhe vlera e tyre pritet të jetë rreth 130,000€. Komuna nuk ka parashikuar buxhet shtesë për provizione apo dalje të mundshme të parasë nga proceset gjyqësore. Nëse paditë gjyqësore vendosen në favor të operatorëve, organizata pritet të ballafaqohet me vështirësi buxhetore në vitet e ardhshme.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisje për PFV

Kryetari i Komunës së Deçanit është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar, si dhe është përgjegjës për kontrole të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime). Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Komuna e Deçanit kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFPP-së nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr. 01/2013 dhe 02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Pyetësin e vet-vlerësimit të komponentëve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit;
- Planin vjetor të prokurimit dhe raportin vjetor të kontratave të nënshkruara publike; dhe
- Harmonizimet tremujore të shpenzimeve dhe të hyrave me Thesar.

PVF-të janë përgatitur në pajtueshmëri me formatin për raportim, si dhe janë nënshkruar dhe dorëzuar brenda afatit ligjor në MF.

Komuna e Deçanit kishte korigjuar PFV-të duke përmirësuar raportimin e tyre, megjithatë edhe pas korigjimit kemi identifikuar mangësi në shpalosje, pasi:

- Pasuria kapitale, jokapitale dhe stoqet nuk janë shpalosur saktë;
- Vlera e shpalosur për obligimet e papaguara është nënvlerësuar për 28,950€; dhe
- Mos shpalosje e drejtë e buxhetit final e të hyrave në ndarjen fillestare dhe finale të buxhetit.

Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të PFV-ve në Ministrinë e Financave, mund të konsiderohet e saktë.

Në kontekst të kërkesave tjera për raportim të jashtëm kemi identifikuar:

- Mos raportimin mujor të obligimeve të papaguara në Thesar/MF; dhe
- Në Raportin Vjetor për Kontratat e Nënshkruara Publike, i dorëzuar në KRPP, nuk është përfshirë kontrata për Mirëmbajtjen Dimërore të Rrugëve në vlerë 44,540€.

2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

Për çështjet e sipër përmendura jepen rekomandimet:

Rekomandimi 1 Kryetari duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për Theksim të Çështjes së opinionit të auditimit, si dhe të marrë veprime specifike për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike dhe për ta konfirmuar regjistrimin e plotë të pasurisë kapitale. Pronat komunale dhe pasuritë jo financiare të blera/ndërtuara duhet të regjistrohen në regjistrin kontabël të SIMFK-së. Zhvlerësimi vjetor dhe i akumuluar për pasurinë jokapitale të zbatohet përmes programit e-pasuria. Më tutje, të sigurohet shpalosje e plotë dhe e saktë e obligimeve të papaguara.

Gjithashtu, Kryetari duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV 2018 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Kjo, gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e PFV-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë ose fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të nënshkruhet përveç nëse ndaj PFV-ve janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme. Edhe kërkesat tjera për raportim të përmbushen konform kërkesave rregullative.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Hyrje

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, në fokus të auditimit ishte menaxhimi i buxhetit, çështjet e prokurimit, burimet njerëzore, pasuritë dhe detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Edhe pse Komuna e Deçanit ka bërë një numër përmirësimesh, ende mbetin një numër fushash ku nevojiten zhvillime të rëndësishme. Çështjet e ngritura nga auditimi i vitit të kaluar nuk janë shqyrtuar sa duhet nga menaxhmenti. Vlerësimi dhe regjistrimi i pasurisë, menaxhimi i projekteve dhe obligimeve vazhdon të mbetet sfidë me të cilën vazhdon të ballafaqohet Komuna. Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi të hyrat në përgjithësi janë të përshtatshme dhe janë duke u zbatuar në mënyrë efektive - por kontrollet mbi një sërë fushash të shpenzimeve kërkojnë përmirësim të mëtejshëm për të parandaluar parregullsinë e shpenzimeve. Përmirësimet kërkojnë kryesisht në menaxhimin e buxhetit për investime kapitale, menaxhimi pasurisë, obligimeve dhe rritjen e inkasimit nga llogaritë e arkëtueshme.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore, shpenzimet e fondeve si dhe të hyrat e arkëtuara sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ¹	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Burimet e Fondeve:	8,176,264	8,436,667	7,532,046	7,314,822	7,314,434
Granti i Qeverisë -Buxheti	6,866,820	6,822,389	6,781,963	6,591,643	6,786,598
Të bartura nga viti paraprak ² -	-	214,889	194,077	478,633	53,067
Të hyrat vetjake ³	1,309,444	1,309,444	466,112	121,745	474,769
Donacionet e jashtme	-	89,945	89,894	122,801	-

¹ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave.

² Të hyrat vetjake të Komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

³ Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e aktiviteteve vetjake.

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 260,402€. Kjo rritje është rezultat i donacioneve të jashtme dhe të hyrave të bartura nga viti paraprak, si dhe ndryshimeve të aplikuara pas rishikimit buxhetor dhe në pajtim me vendimet e Qeverisë.

Në vitin 2017, Komuna e Deçanit ka shpenzuar 89% të buxhetit final ose 7,532,046€, apo 8% më pak krahasuar me vitin 2016. Realizimi i buxhetit mbetet në nivel jo të kënaqshëm dhe më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	8,176,264	8,436,667	7,532,046	7,314,822	7,314,434
Pagat dhe Mëditjet	5,122,049	5,099,351	5,067,475	5,148,007	5,046,369
Mallrat dhe Shërbimet	773,005	846,650	747,702	804,965	618,952
Shërbimet komunale	106,130	121,783	116,641	125,920	127,577
Subvencionet dhe Transferet	66,178	114,178	114,100	107,084	94,089
Investimet Kapitale	2,108,902	2,254,705	1,486,128	1,128,846	1,427,447

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

- Paga dhe Mëditje – buxheti final është zvogëluar për 22,698€. Fillimisht kjo kategori është rritur për 21,734€ nga të hyrat e bartura nga viti paraprak, dhe gjatë vitit me ndryshimet e aplikuara pas rishikimit buxhetor dhe në pajtim me vendimet e Qeverisë është zvogëluar për 44,432€;
- Mallra dhe Shërbime – buxheti final është rritur për 73,645€. Kjo rritje është ndikuar nga të hyrat vetanake të bartura nga viti paraprak në vlerë 50,708€, dhe nga donacionet e jashtme në vlerë 22,937€;
- Shërbimet Komunale – buxheti final është rritur nga të hyrat e bartura prej vitit paraprak në vlerë 15,653€;
- Subvencionet dhe Transferet – buxheti final është rritur nga të hyrat e bartura prej vitit paraprak në vlerë 48,000€; dhe
- Investimet Kapitale – buxheti final është rritur për 145,803€. Kjo rritje është ndikuar nga të hyrat vetanake të bartura nga viti paraprak në vlerë 78,795€, dhe nga donacionet e jashtme në vlerë 67,008€.

Çështja 2 - Realizimi i ulët i buxhetit për investime kapitale

E gjetura Komuna e Deçanit nuk ka arritë të realizojë buxhetin për investime kapitale sipas planit dhe projekteve të synuara. Vetëm 66% e buxhetit për investime kapitale është realizuar, duke rezultuar me suficit buxhetor për 768,578€. Nga 1,486,128€ të paguara për investime kapitale, 84% e tyre apo 1,253,103€ janë procesuar nga Thesari/MF si rezultat i vendimeve gjyqësore dhe përmbarimit për pagesën e borxheve të mëparshme. Në një rast, për pagesën e detyrimeve për investimet kapitale në vlerë 20,000€ thesari kishte shfrytëzuar buxhetin e kategorisë jo përkatëse.

Ekzekutimi i ulët lidhur me projektet kapitale është sfida kryesore me të cilën po përballet komuna. Çështja nuk është adresuar nga menaxhmenti në vitet e fundit edhe pse ajo është trajtuar në raportet e mëparshme të auditimit. Shkak i mos realizimit të buxhetit janë planifikimet e dobëta, pagesat e borxheve për projektet e mëparshme, dhe menaxhimi jo i mirë i planit për projektet e reja kapitale.

Rreziku Ekzekutimi i ulët i buxhetit redukton efektivitetin e planeve vjetore të organizatës. Mos-përmbushja e programit për investime kapitale do të rezultojë si në realizimin e më pak projekteve, ashtu edhe në cilësinë e shërbimeve ndaj qytetarëve. Përveç tjerash, kjo rezulton edhe me kosto shtesë si rezultat i padive dhe pagesave përmes vendimeve gjyqësore.

Rekomandimi 2 Kryetari duhet të sigurojë se është ndërmarrë një vlerësim sistematik i shkaqeve që kanë rezultuar me pagesa përmes vendimeve gjyqësore, por edhe të arsyeve për mos realizim të duhur të buxhetit të investimeve kapitale, duke përcaktuar edhe opsione praktike për përmirësimin e ekzekutimit të tij në vitin e ardhshëm.

3.2 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga Komuna e Deçanit në 2017 ishin në vlerë 492,419€. Pjesa më e madhe e tyre, apo 37%, kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë. Komuna mbledh edhe lloje tjera të hyrave si ato për lejet e ndërtimit, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja dhe taksa tjera administrative.

Tabela 3. Të hyrat vetjake (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2017 Pranimet	2016 Pranimet	2015 Pranimet
Të hyrat vetjake	1,309,444	1,309,444	492,419 ⁴	673,488	629,352

Çështja 3 - Dobësi në planifikim dhe realizim të të hyrave

- E gjetura** Plani i inkasimit të të hyrave për vitin 2017 është realizuar vetëm 38%. Tatimi në pronë si kategori dominuese e të hyrave është realizuar vetëm 65% e planit. Plani i të hyrave nga lejet ndërtimore ishte vlerësuar 600,000€, përderisa ishin realizuar në përqindje shumë të ulët. Ngecje në realizim kishte edhe te llojet tjera të të hyrave.
- Rreziku** Planifikimi jo i drejtë dhe ngecjet në realizim të planit vjetor ndikon negativisht si në aspektin buxhetor të komunës ashtu edhe në mos realizimin e programit vjetor.
- Rekomandimi 3** Kryetari duhet të sigurojë se performanca e inkasimit monitorohet dhe rishikohet në mënyrë sistematike nga drejtoritë përkatëse dhe zyra e financave, dhe që ky rishikim adreson me kohë barrierat që vështirësojnë inkasimin e të hyrave sipas planit.

Çështja 4 - Mos verifikimi i pronave të regjistruara

- E gjetura** Komuna nuk ka ndërmarrë veprime në verifikimin⁵ e 1/3-tës të pronave të regjistruara me qëllim azhurnimin e të dhënave ekzistuese për tatimin në pronë. Ndërsa në dy raste, prona e tatimpaguesit nuk ishte kategorizuar në zonën e duhur të vlerësimit. Pas rekomandimeve tona, në vitin 2018, Komuna ka korrigjuar zonën e vlerësimit në faturat e tatimpaguesve.

⁴ Në këtë vlerë nuk janë përfshirë edhe të hyrat indirekte nga gjobat në trafik dhe dënimet gjyqësore në vlerë totale 64,151€.

⁵ Me UA nr.03/2011 për mbledhjen edhe regjistrimin e informatave mbi pronën dhe tatimpaguesin, kërkohet që brenda vitit të verifikohet 1/3 e pronave të regjistruara.

Rreziku Mos verifikimi i pronave mund të rezultojë me mangësinë që informacioni aktual rreth databazës së tatimit të pronë nuk do të jetë i saktë. Kjo do të ndikojë negativisht në vlerësimin dhe faturimin e tatimit në pronë dhe si rezultat nënvlerësimin e të hyrave nga kjo kategori.

Rekomandimi 4 Kryetari duhet të përmirësoj procesin e verifikimit të pronave dhe të siguroj se verifikimi i 1/3-tës së pronave bëhet në baza të rregullta vjetore, në mënyrë që shënimet rreth tatimit në pronë të janë të plota, për të reflektuar gjendjen reale të pronave të tatuara. Rritja e regjistrimit të pronave do të rezultojë me më shumë të hyra komunale si dhe performancë më të mirë buxhetore.

Çështja 5 – Mangësi në klasifikim, vonesa në regjistrim, dhe menaxhim të lejeve ndërtimore

E gjetura Të hyrat për shfrytëzimin afatgjatë të pronës komunale në vlerë 100,000€, dhe të hyrat për taksën e ndërrimit të destinacionit të tokës në vlerë 2,588€, ishin klasifikuar gabimisht si taksa komunale për leje ndërtimi. Ndërsa në një rast, vendimi për leje ndërtimore për objekt afarist nuk ishte protokoluuar, duke krijuar paqartësi rreth datës së lëshimit të lejes ndërtimore. Gjithashtu, edhe në katër raste tjera, të hyrat ishin regjistruar me vonesë.

Rreziku Keq-klasifikimi dhe vonesat në regjistrimin e të hyrave vështirësojnë harmonizimin e të dhënave dhe raportimin financiar.

Rekomandimi 5 Kryetari duhet të sigurojë se të hyrat klasifikohen dhe regjistrohen me kohë në SIMFK. Vëmendje e shtuar t'i kushtohet edhe menaxhimit dhe protokolimit të dokumentacionit për lejet ndërtimore.

3.3 Pagat dhe shtesat

Pagat dhe shtesat paguhen përmes një sistemi të centralizuar të pagesave që menaxhohet nga Ministria e Administratës Publike dhe MF. Në fund të vitit 2017, Komuna e Deçanit kishte 860 të punësuar, përfshirë edhe anëtarët e Kuvendit Komunal. Për paga dhe mëditje janë shpenzuar 5,067,475€ apo 99% e buxhetit final të kësaj kategorie ekonomike. Pjesëmarrja e shpenzimeve të pagave dhe mëditjeve në shpenzimet totale të komunës është 67%.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.4 Menaxhimi i personelit

Auditimi ynë ka përfshirë dosjet e personelit, procedurat e rekrutimit, vlerësimet vjetore të performancës, pensionimet, pushimet pa pagesë dhe të lehonisë. Personeli administrativ me status të shërbyesve civil menaxhohet nga zyra e personelit në Komunë, ndërsa personeli edukativo-arsimor dhe personeli shëndetësor menaxhohen nga drejtoritë përkatëse, Drejtoria e Arsimit dhe Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.

Çështja 6 – Parregullsi në menaxhimin e personelit

E gjetura

Auditimi në menaxhimin e personelit ka identifikuar se:

- Në procesin e rekrutimit⁶ për mjek të përgjithshëm në Qendrën Komunale të Mjekësisë Familjare, afati i konkursit ishte caktuar 8 ditë e jo 15 ditë, nuk kishte formë zyrtare të aplikacionit për punësim, nuk ishte mbajtur testi me shkrim, konkursi nuk është shpallur në web-faqen e Komunës as në mjete elektronike, njëri nga anëtarët e komisionit intervistues ishte me pozitë infermier, pozitë më e ulët se pozita që përzgjedhet, si dhe mangësi tjera procedurale;
- Përvoja e punës për një mësimdhënës nuk ishte kalkuluar saktë nga Drejtoria Komunale e Arsimit (DKA). Punonjësi kishte dy vite përvojë, ndërsa gabimisht ishte kalkuluar 10 vite. DKA nuk kishte përgatitë as vendim për njohjen e përvojës së punës për punonjësin. Pas rekomandimeve tona, DKA ka ndërmarrë veprimet e nevojshme dhe nga muaji dhjetor 2017 ka bërë korrigjimet në vitet e përvojës së punës dhe ka azhurnuar te dhënat ne sistemin e pagave;
- Vendimi për pushimin e lehonisë për një punonjëse të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, ishte bërë 10 ditë pas fillimit të pushimit të lehonisë. Edhe ndalesa në pagë ishin bërë me një muaj vonesë; dhe
- Kontratat e punës për mësimdhënës, nuk ishin përpiluar sipas formatit të përcaktuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, kjo ngase te pjesa e pagës nuk ishte përcaktuar edhe përvoja e punës dhe gradimi, të cilat së bashku me pagën bazë kullohen në pagë bruto.

Rreziku

Mangësitë e hasura në menaxhimin e personelit, përfshirë procesin e rekrutimit dhe përpilimit të kontratave mund të rezultojnë në paqartësi të mundshme dhe gabime potenciale në shpenzimet e pagave të punonjësve.

⁶ Procesi i rekrutimit është organizuar dhe udhëhequr nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.

Rekomandimi 6 Kryetari duhet të sigurojë se menaxhimi i personelit dhe pagesave bëhet në pajtim me procedurat dhe rregulloret relevante. Në këtë aspekt duhet të forcohen kontrollet në proceset e rekrutimit në mënyrë që komisionet të bëjnë vlerësim objektiv në përputhje me kërkesat e përcaktuara. Gjithashtu të merret në konsideratë rimbursimi i mjeteve të mbipaguara nga kalkulimi jo i saktë i shtesave në pagë nga përvoja e punës.

3.5 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra e shërbime si dhe shërbime komunale në vitin 2017 ishte 968,433€. Prej tyre ishin shpenzuar 864,343€, apo 89% e buxhetit të këtyre dy kategorive. Kryesisht ato kanë të bëjnë me shpenzimet e shërbimeve komunale dhe me aktivitetet operative që ndërlidhen me shërbime tjera kontraktuese, furnizim për zyre dhe pajisje, derivate, mirëmbajtja e ndërtesave, mirëmbajtja e rrugëve lokale, etj.

Çështja 7 - Kontrolle jo efikase në certifikimin e pagesave

E gjetura

Si rezultat i kontrolleve jo efikase, kemi identifikuar se:

- Te pagesa për *Furnizim me dru për ngrohje të shkollave dhe institucioneve shëndetësore*, në vlerë 45,002€, lëndës i mungonte raporti i menaxherit të kontratës dhe kishte vonesë në liferim. Gjithashtu, në disa fletëdergesa nuk ishte specifikuar lloji i drurit të pranuar, ndërsa kishte raste kur ishte pranuar edhe dru ahë. Me kontratë ishte përcaktuar lloji i drurit (kategoria II, qarr ose bungë, dru të thatë jo më shumë se 12% lagështi).
- Pagesa e pagave për punonjësit e angazhuar përmes Marrëveshjeve për Shërbime të Veçanta, ishte bërë në pagën bruto, duke mos u ndalur tatimi në burim dhe kontributi pensional. Pas rekomandimeve tona, zyra e financave ka filluar ndaljen në burim dhe pagesën e tatimit dhe kontributeve pensionale; dhe
- Kërkesa për udhëtim zyrtar jashtë vendit ishte aprovuar me një muaj vonesë.

Rreziku

Mangësitë aktuale mund të rezultojnë në vlerë të dobët për para dhe pagesa të parregullta.

Rekomandimi 7

Kryetari duhet të përforcojë mekanizmat e kontrollit në aprovimin dhe certifikimin e pagesave. Lëndët të procedohen për pagesë vetëm pasi të jenë kompletuar me dokumentacionin e nevojshëm dhe të jenë në përputhje me kushtet e kontratës.

Çështja 8 – Blerjet përmes procedurave të prokurimit.

- E gjetura** Për shkak të mungesës së mbikëqyrjes efektive menaxheriale kanë rezultuar këto mangësi:
- Te kontrata për Furnizim me karburante për Komunën e Deçanit, shkolla, QKMF dhe shtëpinë e komunitetit në vlerë të parashikuar 100,000€, siguria e ekzekutimit nuk mbulonte edhe periudhën një mujore pas përfundimit të kontratës; dhe
 - Me planin e prokurimit, blerjet për furnizim me material zyrtar, ishin parashikuar të jenë 13,594€, ndërsa vlera e kontraktuar ishte 24,593€.
- Rreziku** Kontratat mund të mos realizohen sipas kushteve kontraktuale dhe obligimet të mos mund të paguhen në mungesë të mjeteve buxhetore.
- Rekomandimi 8** Kryetari duhet të sigurojë se sigurimi për ekzekutimin e kontratave të jetë sipas afateve të përcaktuara me legjislacionin rregullativ të prokurimit publik, dhe se kontratat e nënshkruara të mos tejkalojnë vlerat e parashikuara buxhetore.

3.6 Subvencionet dhe transferet

Komuna e Deçanit ka shpenzuar pothuajse tërë buxhetin final për subvencione dhe transfere. Subvencionet janë dhënë për përfitues individual dhe për entitete jo publike.

Çështja 9 – Mungesë e monitorimit për projektet e subvencionuara

- E gjetura** Komuna e Deçanit nuk ka monitoruar sa duhet projektet e subvencionuara. Mungonin edhe raportimet nga përfituesit e subvencioneve. Në dy raste në lëndë mungonin edhe vlerësimet e kërkesave për subvencion nga komisioni përkatës.
- Rreziku** Projektet e subvencionuara mund të mos kenë arritur qëllimin e financimit në mungesë të raportimeve dhe vlerësimit të kërkesave.
- Rekomandimi 9** Kryetari duhet të sigurojë se projektet e subvencionuara monitorohen nga Komuna dhe se përfituesit e subvencioneve dorëzojnë raporte për realizimin e projekteve të financuara.

3.7 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 2,254,705€, ndërsa janë shpenzuar 1,486,128€, ose 66% e buxhetit. Ato kanë të bëjnë me financimin e projekteve kapitale në infrastrukturën rrugore, rrjetin e ujësjellësit, objekteve sportive, hartimin e projekteve, etj.

Çështja 10 - Dobësi në menaxhimin e projekteve kapitale.

E gjetura Zbatimi i prituri i udhëzimeve dhe rregulloreve nuk është arritur për shkak të mungesës së mbikëqyrjes efektive menaxheriale. Kjo ka rezultuar në:

- Vonesa në realizimin e kontratës *Punimi i Sallës së Sportit* në vlerë 367,300€. Projekti kishte filluar në vitin 2013, dhe afati i implementimit të kontratës ishte 120 ditë pune. Në mungesë të mjeteve buxhetore, projekti ende nuk ishte përfunduar;
- Menaxherët e kontratave hartojnë raporte të pranimit, por informatat e dhëna nuk ofrojnë shpjegime të mjaftueshme rreth zbatimit të kontratave. Planet e menaxhimit të kontratave përveç nënshkrimit fillestar nuk përditësohen me informata plotësuese rreth ecurisë së implementimit dhe përfundimit të kontratave. Gjithashtu, raportet e pranimit të SIMFK-së nuk ishin nënshkruar nga zyrtari i certifikuar për pranim por nga menaxherët e kontratave. Pas rekomandimeve tona, ka filluar nënshkrimi i këtyre raporteve nga zyrtari përkatës; dhe
- Pranimi teknik i punimeve për projektin *Renovimi i kanalizimit në shtëpinë e komuniteteve në Deçan*, në vlerë 9,295€, ishte bërë me gati një muaj vonesë nga data e caktimit të komisionit;

Rreziku Dobësitë aktuale mund të ndikojnë në vlerë të dobët për para dhe mos realizim të kontratave sipas kushteve kontraktuale.

Rekomandimi 10 Kryetari duhet të sigurojë se kontratat të nënshkruhen vetëm pasi të sigurohet buxheti i duhur për realizimin e tyre. Menaxherët e kontratave të monitorojnë rregullisht zbatimin e projekteve, dhe të hartojnë raporte në të cilat ofrohen informata të mjaftueshme rreth ecurisë së zbatimit.

Çështja 11 - Planifikim jo i drejtë dhe vonesa në incimin e procedurave të prokurimit

E gjetura Incimi i procedurave të prokurimit për *Blerjen dhe montimin e dritareve në Qendrën për Punë Sociale*, në vlerë 12,456€, ishte vonuar pesë muaj nga aprovimi fillestar. Kjo pasi, paramasa dhe parallogaria ishte dashur të korrigohej si pasojë e mbivlerësimit nga ana e njësisë kërkuese dhe tejkalonte vlerën e buxhetuar por edhe vonesave tjera procedurale.

Rreziku Vonesat në incimin e procedurave të prokurimit ndikon negativisht në realizimin e planeve dhe objektivave të përcaktuara.

Rekomandimi 11 Kryetari duhet të sigurojë se njësitë kërkuese planifikojnë drejtë dhe bazohen në nevoja reale vjetore. Procedurat e prokurimit të zhvillohen sipas planit dhe afateve të përcaktuara.

Çështja 12 - Klasifikimi jo i drejtë i shpenzimeve

E gjetura Në tri kontrata të testuara në vlerë 35,836€ kemi identifikuar keq-klasifikim të shpenzimeve sipas kodeve ekonomike, si:

- Mjetet e zotuar për kontratën *Blerja dhe montimi i kamerave në vende publike* në vlerë 9,561€ ishte klasifikuar si furnizim me rrymë, gjenerim dhe transmision;
- Shpenzimet për kontratën *Blerja e një automjeti për QKMF*, në vlerë 16,980€ është klasifikuar si veturë e ndihmës së shpejtë, ndonëse vetura nuk ishte e atij lloji; dhe
- Shpenzimi për kontratën *Renovimi i kanalizimit në shtëpinë e komunitetit*, në vlerë 9,295€, ishte klasifikuar në kodin e ndërtesave të banimit.

Rreziku Keq-klasifikimi i shpenzimeve ndikon në raportim jo të drejtë financiar për llojet shpenzimeve. Kjo rezulton në mbivlerësimin e një lloji të shpenzimeve kundrejt nënvlerësimit të shpenzimit tjetër.

Rekomandimi 12 Kryetari duhet të sigurojë kontrolle shtesë në sektorin e financave në mënyrë që shpenzimet të planifikohen dhe regjistrohen në kode përkatëse ekonomike.

3.8 Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale

Në vijim janë çështjet e përbashkëta në fushën e prokurimit që kanë të bëjnë me mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale.

Çështja 13 – Planifikimi dhe blerjet përmes procedurave të prokurimit

E gjetura Zbatimi i prituri i udhëzimeve të prokurimit nuk është arritur për shkak të mungesës së mbikëqyrjes efektive menaxheriale. Kjo ka rezultuar në:

- Ngecje në realizimin e planit të prokurimit, pasi 14 kontrata pune të planifikuara në vlerë 1,903,000€ dhe tri kontrata për furnizime në vlerë 144,000€, nuk janë nënshkruar. Kjo ka rezultuar si pasojë e shfrytëzimit të buxhetit nga Thesari për pagesën e obligimeve të mëparshme si rrjedhojë e vendimeve gjyqësore dhe përmbarimit, por edhe vonesave tjera nga njësitë kërkuese;
- Për *furnizim dhe montim të kamerave* janë nënshkruar dy kontrata me kuotim çmimi dhe tri kontrata minimale në vlerë totale 22,383€. Për *furnizim me pajisje elektronike*, janë nënshkruar katër kontrata me kuotim çmimi në vlerë totale 18,975€;
- Në dy raste nuk ishin zotuar mjetet e mjaftueshme buxhetore për blerjet e planifikuara. Rasti parë ka të bëjë me kontratën *Mirëmbajtja hixhenike e objektit të administratës komunale dhe objekteve publike*, në vlerë të parashikuar 112,320€, për të cilën ishin zotuar vetëm 5,000€, ndërsa rasti dytë ndërlidhet me kontratën për *Ndërtimin e rrugës në Vranoc*, në vlerë 24,447€, për të cilën ishin zotuar 20,000€; dhe
- Në katër raste, zotimi dhe urdhërblerja janë përgatitur me vonesë. Në një rast, në mungesë të zotimit të mjeteve të mjaftueshme ishin paguar vetëm 10,000€ nga obligimi prej 19,367€.

Rreziku Dobësitë në planifikim dhe realizim të aktiviteteve të prokurimit mund të ndikojnë negativisht në aspektin buxhetor dhe në zbatim të kontratave.

Rekomandimi 13 Kryetari duhet të sigurojë se është ndërmarrë një rishikim për të gjeturat e auditimit ku proceset nuk janë aplikuar në mënyrë efektive për të përcaktuar se pse kanë ndodhur dështimet dhe pse nuk është aplikuar mbikëqyrja e përshtatshme. Në këtë aspekt, të bëhen analiza të detajuara lidhur me planifikimin dhe realizimin e kontratave për projektet kapitale. Me tutje, të sigurohet se procesi i pagesave bëhet në pajtim të plotë me hapat e përcaktuar me LMFPP-në, dhe me rregullat e Thesarit.

3.9 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Sipas PVF-ve, vlera neto e pasurisë kapitale në fund të vitit është 15,393,334€, ndërsa e pasurisë jokapitale 125,799€. Në fund të vitit 2017 Komuna e Deçanit ka krijuar komision punues dhe ka bërë vlerësimin dhe njehsimin fizik të pasurisë në fund të vitit. Mangësitë në regjistrin e pasurisë janë trajtuar në pjesën 2.1 Baza për opinion - Theksimi i Çështjes. Përveç kësaj, janë hasur edhe mangësi tjera të prezantuara në vijim:

Çështja 14 – Dobësi në menaxhimin e pasurisë

- E gjetura** Komuna e Deçanit nuk ka menaxhuar si duhet pasurinë. Për një pjesë të pasurisë së regjistruar në e-pasuri, nuk është përcaktuar qartë lokacioni se ku ndodhen, apo edhe informatat sipas punonjësve me pasurinë e ngarkuar. As për stoqet apo materialin shpenzues nuk kishte evidencë të plotë.
- Rreziku** Mungesa e një regjistri të përgjithshëm të pasurisë, vështirëson menaxhimin e duhur të pasurisë, dhe se nuk përmbushë kërkesat ligjore për raportim të drejtë financiar.
- Rekomandimi 14** Kryetari duhet të sigurojë se kërkesat ligjore për regjistrimin dhe menaxhimin e pasurisë përmbushen në tërësi.

Çështja 15 – Mungesë e kontrolleve në menaxhimin e automjeteve zyrtare

- E gjetura** Ekzistojnë dobësi në menaxhimin e automjeteve zyrtare. Nga testimet e bëra, vërejtëm se nuk ka evidencë të plotë e të saktë rreth shfrytëzimit të automjeteve zyrtare, nuk plotësohen urdhëresat e udhëtimit dhe nuk evidentohen kilometrat e kaluara.
- Rreziku** Mungesa e kontrolleve dhe menaxhimit rrit rrezikun që automjetet të shfrytëzohen edhe për qëllime tjera jo zyrtare dhe përdorimit të pa autorizuar të tyre, përfshirë edhe rritjen e shpenzimeve për karburante, për servisimin dhe mirëmbajtjen e tyre.
- Rekomandimi 15** Kryetari duhet të sigurojë se automjetet zyrtare shfrytëzohen në pajtim me rregullat dhe kërkesat ligjore. Për secilin automjet zyrtar të shfrytëzuar duhet të mbahet evidencë e plotë dhe e saktë lidhur me kilometrat e kaluara, serviset e bëra si dhe të dhëna tjera të nevojshme.

3.10 Të arkëtueshmet

Llogaritë e arkëtueshme (LI/A) kanë të bëjnë me tatimin në pronë dhe të hyrat nga qiraja për shfrytëzimin e pronës komunale.

Çështja 16 - Menaxhimi jo i mirë i llogarive të arkëtueshme

E gjetura Llogaritë e arkëtueshme nuk janë menaxhuar si duhet. Menaxhmenti nuk ka ndërmarrë veprimet e nevojshme në inkasimin me kohë të të hyrave. Siç edhe është prezantuar në PVF, vlera e përgjithshme e tyre arrin në 1,385,263€, ku 87% e tyre i takojnë tatimit në pronë. Sipas raporteve të Komunës në tri raste prona komunale shfrytëzohet pa kontratë.

Rreziku Shfrytëzimi i pronave pa kontratë dhe vonesat në inkasimin e të hyrave reduktojnë fondet e mbledhura për buxhetin e Komunës.

Rekomandimi 16 Kryetari duhet të siguroj që po shqyrtohen në mënyrë aktive të gjitha opsionet e mundshme me qëllim të rritjes së efikasitetit në mbledhjen e të arkëtueshmeve, përfshirë edhe mjetet ligjore, për të siguruar inkasimin me kohë të tyre.

3.11 Obligimet e papaguara

Sipas PFV-ve, obligimet e papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2017 ishin 420,380€. Këto obligime janë bartur për t'u paguar në vitin 2018. Përveç detyrimeve financiare, Komuna e Deçanit përballet edhe me detyrime kontingjente, dhe vlera e tyre pritet të jetë rreth 130,000€.

Çështja 17 - Menaxhim i dobët i obligimeve

E gjetura Komuna nuk ka menaxhuar si duhet obligimet ndaj furnitorëve. Obligimet e papaguara kanë të bëjnë kryesisht me furnizime për zyre, derivate, reprezentacion, mirëmbajtje si dhe shpenzime për shërbime komunale. Obligimet nuk janë paguar për shkak të hyrjes në to, pa u siguruar mjetet e mjaftueshme buxhetore. Janë evidentuar edhe vonesa në pagesë, mos pagesë e plotë e obligimit të faturuar si dhe raste të mos protokollimit të faturave me rastin e pranimit.

Rreziku Hyrja në obligime pa u siguruar paraprakisht mjetet financiare si dhe mos pagesa me kohë e obligimeve mund të shkaktojë kosto shtesë dhe dëmtim të buxhetit nga ngritja e padive gjyqësore prej furnitorëve. Mos protokolimi i rregulltë i faturave të pranuar, mund të rezultojë me vonesa në pagesën e borxheve apo edhe me pagesa të dyfishta.

Rekomandimi 17 Kryetari duhet të sigurojë kontrolle shtesë në menaxhimin e obligimeve ndaj kontraktuesve. Obligimet të paguhen brenda afatit kohor prej 30 ditëve nga data e pranimit të faturave. Një proces i rregulltë i evidentimit duhet të zbatohet kur faturat pranohen nga furnitorët.

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të të vitit 2016 të Komunës së Deçanit ka rezultuar në 20 rekomandime. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2017, tetë rekomandime janë zbatuar; shtatë ishin në proces të zbatimit dhe pesë nuk janë adresuar ende. Po ashtu, nga viti 2015 ishin bartur edhe 17 rekomandime, dhe në vitin 2017, pesë nga to ishin zbatuar, gjashtë rekomandime tjera ishin në zbatim e sipër dhe gjashtë nuk janë adresuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni Shtojcën II.

Çështja 18 – Nivel i ulët i zbatimit të rekomandimeve nga viti paraprak dhe viti i mëhershëm.

E gjetura Komuna e Deçanit ka zbatuar kërkesat për të hartuar një plan veprimi brenda 30 ditëve pas pranimit të raportit të auditimit për vitin 2016 të ZKA-së, mirëpo kjo nuk është mbështetur me një proces konfirmues ku zbatimi i rekomandimeve monitorohet formalisht. Kjo pasqyron mungesën e fokusit nga menaxhmenti për të siguruar që rekomandimet zbatohen me kohë dhe pengesat për veprim pritet të identifikohen dhe adresohen. Një qasje e tillë është e nevojshme për të menaxhuar përmirësim të vazhdueshëm në tërë organizatën

Përderisa vetëm pjesërisht janë zbatuar disa nga rekomandimet e vitit 2016 dhe ato të viteve të mëhershme, mangësitë në sistemet domethënëse mbesin të pa trajtuara sa duhet. Ne nuk kemi vërejtur se menaxhmenti aplikon masa përgjegjësie për mos zbatimin e rekomandimeve.

Rreziku Mos zbatimi i rekomandimeve të dhëna në vitin e kaluar dhe viteve të mëhershme, shpie te rreziku që përmirësimet e kërkuara të proceseve operacionale dhe të tjera mund të mos zbatohen duke rezultuar në mos efikasitet të vazhdueshëm dhe humbje financiare.

Rekomandimi 18 Kryetari duhet të siguroj që zbatimi i planit të veprimit, monitorohet në vazhdimësi dhe raportohet në baza të rregullta mujore ose tre mujore në lidhje me progresin e arritur në këtë drejtim. Rekomandimet të cilat nuk zbatohen sipas afateve, të rishikohen në një afat të shkurtër nga kryetari, si dhe të ndërmerren veprime pro-aktive ndaj barrierave të paraqitura gjatë zbatimit.

5 Qeverisja e mirë

Hyrje

Qeverisja e mirë nënkupton parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontrolleve, menaxhimin e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA-së me auditimin e brendshëm dhe qeverisjen e mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmerr veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK-së nga ana e organizatave buxhetore po monitorohet edhe nga plotësimi i pyetësorëve të vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat në fund të vitit i dorëzohen MF-së.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentat tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Ekziston ende një numër i dobësive të qeverisjes brenda Komunës së Deçanit veçanërisht në lidhje me menaxhimin e rrezikut dhe cilësinë e raportimit menaxherial. Përgjigja efektive ndaj rekomandimeve të auditimit dhe operimi i një sistemi cilësor të auditimit të brendshëm, nuk janë të vendosura sa duhet. Komiteti i auditimit është themeluar më vonë, ndërsa rekomandimet e auditimit të brendshëm nuk janë adresuar në nivelin e duhur. Menaxhmenti organizon takime me zyrtarët udhëheqës, por nuk ka vendosur një proces formal të raportimit të brendshëm nga drejtorit komunale.

Të gjitha organizatat buxhetore janë të obliguara të përgatisin dhe të përcjellin planet strategjike në nivel të organizatës por edhe planet vjetore, si: planet urbanistike, hapësinore, plani operativ emergjent, plani strategjik kundër korrupsionit, strategjia e zhvillimit rajonal etj. Komuna e Deçanit ka hartuar Strategjinë zhvillimore lokale dhe të tjera, por jo edhe planet vjetore të punës sipas drejtorive për 2017.

5.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me dy auditor. Për të kryer një auditim efektiv nevojitet një program gjithëpërfshirës i punës që reflekton rreziqet financiare dhe të tjera të entitetit të audituar dhe që ofron siguri të mjaftueshme mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Ndikimi i produkteve të Auditimit të Brendshëm duhet të gjykohet nga rëndësia që i jep menaxhmenti adresimit të rekomandimeve si dhe nga mbështetja e ofruar nga një Komitet efektiv i Auditimit.

Çështja 19 - Nivel i ulët i zbatimit të rekomandimeve të NjAB-së.

E gjetura Nuk janë përgatitur plane veprimi për adresimin e rekomandimeve të NjAB-së. Nga 40 rekomandimet e dhëna në raportet e auditimit të brendshëm, NjAB ka vlerësuar se vetëm 16 prej tyre janë zbatuar, 13 në proces të zbatimit dhe 11 nuk ishin zbatuar. Mandati i Komiteti i Auditimit kishte skaduar në mars 2017, dhe për tremujorin e parë nuk ishte mbajtur ndonjë takim pune. Në prill të vitit 2018, menaxhmenti ka krijuar komitet të ri të Auditimit.

Këto rezultate pasqyrojnë mungesën e vëmendjes së menaxhmentit në njohjen dhe maksimizimin e përfitimit të auditimit të brendshëm ose për të kërkuar siguri për funksionimin efektiv të kontrolleve të brendshme.

Rreziku Mangësitë e identifikuara zvogëlojnë sigurinë që i ofrohet menaxhmentit në lidhje me funksionimin e sistemeve financiare. Kjo mund të rezultojë me dobësi tjera të paidentifikuara, mos reagim me kohë ndaj sfidave potenciale dhe vazhdim të praktikave joefektive që mund të përfundojnë me vlerë të ulët për para dhe/apo humbje potenciale financiare për komunën.

Rekomandimi 19 Kryetari duhet të sigurojë që përveç përgatitjes së planeve të veprimit të nga njësitë e audituara, të sigurojë se procesi në zbatimin e rekomandimeve monitorohet vazhdimisht nga menaxhmenti. Komiteti i Auditimit duhet t'i rishikoj rezultatet e auditimit të brendshëm dhe veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti në lidhje me rekomandimet e auditimit të brendshëm.

5.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Për të pasur një planifikim të mirë, për të mbikëqyrë aktivitetet në baza të rregullta dhe për të mundësuar vendimmarrje efektive, menaxhmenti ka nevojë të posedoj raporte të rregullta. Llogaridhënia si proces është pranim i përgjegjësive, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalosje e rezultateve në mënyrë transparente. Ndërsa, menaxhimi i rrezikut është një proces që ka të bëjë me identifikimin, analizën, vlerësimin dhe veprimet/masat e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguar ndaj rrezeve që kërcënojnë organizatën.

Menaxhmenti, ndonëse ka zbatuar një numër kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet funksionojnë si duhet, ne kemi vërejtur se masat e aplikuar janë të dobëta dhe jo efektive dhe nuk mundësojnë një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

Çështja 20 - Dobësi në kontrollet menaxheriale dhe raportim të brendshëm

E gjetura Si pasojë e kontrolleve të pamjaftueshme menaxheriale, një pjesë e konsiderueshme e buxhetit për investime kapitale nuk është shpenzuar. Obligimet e papaguara, mbikëqyrja e pamjaftueshme dhe hyrja në obligime pa mjete të mjaftueshme buxhetore nuk ishin trajtuar me kohë dhe në mënyrën e duhur nga ana e menaxhmentit. Disa prej projekteve as që kanë filluar, ndërkohë që disa kontrata ishin subjekt i shqyrtimeve gjyqësore dhe procedurave përmbarimore. Menaxhmenti nuk posedon analiza të rregullta për ecuritë buxhetore, nuk rishqyrton planin e prokurimit dhe nuk ka raporte të rregullta për aktivitetet operative. Kjo ka ndodhur sepse përgjegjësitë përcjellëse për raportim të brendshëm nuk zbatohen në mënyrë efektive. Drejtoritë komunale nuk kishin përgatitur as plane vjetore të punës për vitin 2017.

Rreziku Kërkesat e dobëta të llogaridhënies, planifikimit dhe raportimit menaxherial reduktojnë efektivitetin e menaxhimit financiar dhe operativ. Kjo rezulton me dobësi në procesin e buxhetit dhe e zvogëlon aftësinë e menaxhmentit për të reaguar ndaj sfidave financiare me kohë. Po ashtu, kjo ulë efektin e kontrolleve buxhetore dhe rrit rrezikun për shpenzime të parregullta. Rrjedhimisht, kjo mund të rezultojë edhe me ofrimin e shërbimeve jo cilësore.

Rekomandimi 20 Kryetari duhet të siguroj se ecuritë buxhetore, përfshirë planin e prokurimit dhe shpenzimet do të jenë subjekt i analizave dhe rishikimeve të rregullta nga ana e komunës. Gjithashtu, të përcaktohet forma e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili kërkohet që të mbështesë menaxhimin efektiv të veprimtarisë. Rendësi e veçantë t'i kushtohet edhe përgatitjes së planeve dhe raporteve vjetore nga secila drejtori komunale.

Çështja 21 - Mungesa e pozitës për Zyrtar Kryesor Financiar

E gjetura Komuna e Deçanit nuk ka Zyrtar Kryesor Financiar (ZKF). Sipas LMFPP dhe Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, çdo organizatë buxhetore duhet ta ketë Zyrtarin Kryesor Financiar. ZKF është përgjegjës për veprimtarinë e rregulltë dhe të ligjshme financiare të organizatës përkatëse buxhetore.

Rreziku Në mungesë të ZKF-së mund të krijohen paqartësi në ndarjen dhe delegimin e detyrave dhe përgjegjësi në menaxhimin financiar.

Rekomandimi 21 Kryetari duhet të sigurojë se pjesë e strukturës organizative të Komunës të jetë edhe pozita e Zyrtarit Kryesor Financiar.

Çështja 22 - Mungesa e menaxhimit të rrezikut

- E gjetura** Komuna nuk ka politika të shkruara dhe procedura për menaxhimin e rreziqeve, në veçanti rrezikut të mashtrimit dhe parregullsive. Ende nuk ekziston ndonjë regjistër i rreziqeve i hartuar sipas kërkesave të MFK-së, nuk ka strategji për menaxhimin e rrezikut, dhe nuk përgatitet ndonjë raport për menaxhimin e tyre. Kjo ka ndodhur si mungesë e llogaridhënies tek menaxhmenti i lartë lidhur me procesin e menaxhimit të rrezikut si dhe mungesës së njohurive brenda drejtorive për rolet e tyre në ofrimin e mbështetjes për këtë proces.
- Rreziku** Mungesa e menaxhimit efektiv dhe gjithëpërfshirës të rrezikut do të dobësoj cilësinë e shërbimit ndaj qytetarëve nëse çështjet e brendshme dhe të jashtme që ndikojnë në këtë, nuk adresohen në kohën e duhur. Kjo për shkak se veprimet pro aktive të nevojshme për të parandaluar ose evituar ndikimin e çështjeve të tilla nuk do të ndërmerren në mënyrë të planifikuar dhe sistematike
- Rekomandimi 22** Kryetari duhet të sigurojë se është deleguar përgjegjësia e drejtpërdrejtë për menaxhimin e rrezikut nëpër sektorët përkatës të administratës dhe të sigurojë raportim tremujor për zbatimin e kërkesave në këtë fushë.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet të japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të dy viteve paraprake

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e bartura nga viti 2015	Të zbatuara gjatë vitit 2017	Në proces të zbatimit gjatë 2017	Të pa zbatuara
1.4 PVF dhe kërkesat tjera për raportim	Kryetari duhet të sigurojë që është bërë një analizë për të përcaktuar arsyet për kualifikimin e opinionit të auditimit dhe paragrafin e theksimit të çështjes. Duhet të ndërmerret veprimi për të adresuar dobësitë e rëndësishme në një mënyrë sistematike dhe pragmatike për të zbutur dobësitë e shpalosura në paragrafin e bazës për opinion të kualifikuar.		Me përjashtim të mangësive në shpalesje, pjesa e parë e PVF është prezantuar drejtë.	
	Kryetari duhet të marrë masat e duhura për të siguruar pajtueshmëri rregullative të plotë të procesit të përgatitjes së pasqyrave vjetore financiare (PVF).		Mangësitë janë hasur në shpalesje.	
2.3 Zbatimi i rekomandimeve nga viti paraprak	Kryetari i komunës duhet të rishikoj Planin e Veprimit për adresimin e rekomandimeve të vitit paraprak. Ky plan duhet të përcaktojë një kornizë të arsyeshme kohore të zbatimit, personel përgjegjës dhe modalitet në aplikim, duke u fokusuar fillimisht në fushat e rëndësishme të lartë, dmth. ku janë identifikuar dobësi domethënëse. Progresi i planit duhet të monitorohet direkt nga Kryetari.		Edhe më tutje kemi rekomandime të pa zbatuara, sidomos në realizim të buxhetit të investimeve kapitale dhe në qeverisje.	
2.4 Lista kontrolluese e vetëvlerësimit të MFK-së	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që lista e vetëvlerësimit është plotësuar siç kërkohet nga Ministria e Financave.	Po		

2.5.1 Rishikimet specifike të qeverisjes	Kryetari duhet të sigurojë një rishikim të kërkesave ekzistuese të llogaridhënies dhe të raportimit ndaj drejtorive komunale si dhe të siguroj aranzhime të përmirësuara për të arritur objektivat specifike brenda një viti.			Nuk janë marrë masa.
2.5.2 Menaxhimi i riskut	Kryetari duhet të sigurojë që procedurat dhe sistemet e menaxhimit të riskut janë krijuar dhe janë funksionale. Për më tepër, përgjegjësia për menaxhimin e riskut është deleguar direkt tek një drejtor përkatës që të sigurojë raportimin mujor mbi zbatimin e kërkesave në këtë fushë dhe të sigurojë se risqet janë duke u menaxhuar.			Nuk janë marrë masa.
2.5.3 Dobësi në Kontrollin Menaxherial	Kryetari i Komunës duhet të rishikojë masat ekzistuese të qeverisjes së përgjithshme dhe cilësinë e raportimit të brendshëm të Komunës. Kërkesat pazbatuara duhet të adresohen deri në fund të vitit 2016. Cilësia e raportimit dhe mbikëqyrjes buxhetore duhet të shqyrtohet në mënyrë kritike dhe sistematike për të siguruar arritjen e objektivave të Komunës.			Nuk janë marrë masa.
2.7 Sistemi i auditimit të brendshëm	Kryetari duhet të sigurojë që Komiteti i Auditimit është funksional dhe kryen detyrat e veta siç kërkohet me ligj. Për më tepër, Kryetari duhet të sigurojë që aktiviteti i ardhshëm i AB duhet të drejtohen në drejtim të zhvillimit dhe zbatimit të strategjisë së auditimit të bazuar në risk. Gjithashtu, në mënyrë që përfitimet të jenë të dukshme, Kryetari duhet të marrë masa për zbatimin e rekomandimeve të AB brenda Komunës.		Është krijuar Komiteti i Auditimit, por nuk janë hartuar plane veprimi për zbatimin e rekomandimeve.	
3.4 Prokurimi	Kryetari duhet të identifikoj shkaqet rrënjësore të mangësive dhe të ndërmarrë masat e duhura për të siguruar se kërkesat e ligjit të prokurimit janë zbatuar plotësisht.		Janë caktuar menaxherët e kontratave, por janë hasur raste që fondet e zotuar janë më të ulëta se kontraktimet.	

3.5.1 Shpenzimet tjera	Kryetari duhet të siguroj që Komuna të ndërmarrë hapa të mëtutjeshëm për përmirësimin e kontrolleve mbi shpenzimet dhe pagesat që ato të jenë në pajtueshmëri me ligjet dhe rregulloret përkatëse.	Po		
3.5.3 Subvencionet dhe Transferet	Kryetari duhet të adresojë çështjen dhe të marrë masat e duhura për të siguruar që shpenzimet e bëra me urdhër të gjykatës janë të dokumentuara mjaftueshëm dhe janë kategorizuar dhe klasifikuar në mënyrë të duhur para lëshimit të pasqyrave financiare vjetore.		Përveç një pagese të procesuar nga buxheti i subvencioneve për shpenzimet kapitale, pjesa tjetër është klasifikuar si duhet.	
3.6 Të hyrat	Të përmirësohen sistemet e faturimit dhe të kontabilitetit në mënyrë që të sigurojë kontrolle të sigurt, efikente dhe efektive në faturim dhe të hyra. Përmirësimi i procedurave lidhur me sisteme të tilla do të mundësonte menaxhmentin të monitoroj dhe të menaxhoj risqet e mëdha, dhe të siguroj që vendimet lidhur me buxhetimin, planifikimin dhe arkëtimin e të hyrave bëhen në mënyrë të duhur. Të sigurohet që anketimet dhe kushtëzimi i provizionimit të shërbimeve bëhet siç kërkohet me Udhëzimin Administrativ Nr. 03/2011 dhe Nr. 07/2011.			Nuk janë marrë masa.
3.7 Pasuritë dhe detyrimet 3.7.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Kryetari duhet të sigurojë regjistrimin në kohë dhe të saktë të të gjitha pasurive në regjistrat përkatës, në përputhje me kërkesat e rregullores 02/2013. Ai gjithashtu duhet të sigurojë që pasuritë kapitale të cilat regjistrohen përmbajnë informacion të plotë, duke përfshirë datën kur pasuria është vënë në përdorim, në mënyrë që llogaritja e zhvlerësimit të mund të kryhet me saktësi. Si dhe të përcaktojë statusin e pronësisë.			Nuk janë marrë masa.
Inventarizimi i pasurisë kapitale	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që inventarizimi i pasurive kapitale jo-financiare është kryer në pajtim me Rregulloren në fuqi për pasuritë jo-financiare të OB.	Po		

Shpalosja e pasurisë jo-kapitale me vlerë nën 1,00 €	Të sigurohet që Komuna mban informacion të saktë dhe të plotë në lidhje me pasuritë jo kapitale dhe të siguroj se pasuritë janë zhvlerësuar në bazë të rregullores në fuqi.			Nuk janë marrë masa.
3.7.2 Trajtimi i parasë gatshme.	Të sigurohet se depozitat e përditshme të parasë dhe kontrollet janë kryer ashtu siç kërkohet nga legjislacioni në fuqi.	Po		
3.7.3 Trajtimi i të arketueshmeve	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që llogaritë e arkëtueshme janë shpalosur në mënyrë efikase dhe të detajuar, dhe për to mbahen dokumente dhe informacione të mjaftueshme.	Po		
3.7.4 Trajtimi i borxheve	Kryetari duhet të sigurojë që Komuna të ndërmarrë hapa të metutjeshëm dhe të zhvilloj plane veprimi për të bërë pagesat brenda periudhës së kërkuar.		Edhe këtë vit ka pasur pagesa përmes vendimeve gjyqësore, por niveli i borxheve është përgjysmuar në krahasim me vitin e kaluar.	
Komponenta e auditimit	Rekomandimet e dhëna në vitin 2016	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
1. 3 Pasqyrat Vjetore Financiare	Kryetari duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për Kualifikim Opinionit dhe Theksim të Çështjes. Të ndërmerren veprime për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike për t'i hequr gabimet në klasifikimin e shpenzimeve jo-kapitale dhe për të bërë vlerësimin e saktë të pasurive kapitale.		Me përjashtim të mangësive në shpalosje, pjesa e parë e PVF është prezantuar drejtë.	
	Kryetari duhet të siguroj që procesi i përgatitjes së PVF-ve plotësisht adreson dobësitë e identifikuar në PVF.		Mangësitë janë hasur në shpalosje.	

2.1 Zbatimi i rekomandimeve	Kryetari duhet të siguroj se do të zbatohet një proces i forcuar i llogaridhënies së stafit përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve, sipas afateve kohore dhe prioriteteve të përcaktuara me planin e veprimit. Monitorimi i progresit të rekomandimeve duhet të bëhet në mënyrë sistematike, dhe aty ku ka ngecje, të propozohen masat adekuate.		Edhe më tutje kemi rekomandime të pa zbatuara, sidomos në realizim të buxhetit të investimeve kapitale dhe në qeverisje.	
2.2 Vet-vlerësimi / Menaxhimi i rrezikut	Kryetari duhet të siguroj se është hartuar lista e rreziqeve të mundshme, dhe të caktojë personat përgjegjës për menaxhimin e këtyre rreziqeve, dhe të kërkojë nga ta raportim në baza të rregullta mbi mbarëvajtjen e procesit.			Nuk janë marrë masa.
2.3.2 Raportimi menaxherial	Kryetari duhet të siguroj se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili mund të nxirren të gjitha informatat relevante që ndikojnë në vendim marrjen cilësore dhe me kohë të menaxhmentit.			Nuk janë marrë masa.
2.4 Auditimi i Brendshëm	Kryetari duhet të rishikoj arsyet për veprimet e limituara të ndërmarra nga menaxhmenti, në lidhje me rekomandimet e auditimit të brendshëm, dhe të koordinoj bashkëpunimin me Komitetin e Auditimit për ngritjen dhe përmirësimin e cilësisë së kontrollit të brendshëm.		Është krijuar Komiteti i Auditimit, por nuk janë hartuar plane veprimi për zbatimin e rekomandimeve.	
3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	Kryetari duhet të siguroj që me rastin e planifikimit vjetor të buxhetit të konsideroj aspektin e likuidimit të borxheve të mbetura nga vitet e kaluara, e më pas të analizoj fondet e duhura për realizimin e projekteve kapitale për vitin aktual, duke parandaluar bartjen e obligimeve nga viti në vit.			Nuk janë marrë masa.

3.1.1 Të hyrat	Kryetari duhet të siguroj një proces të harmonizimeve të rregullta mujore ndërmjet drejtorive komunale dhe administratës së financave, duhet të vendos kontrole adekuate sa i përket mbledhjes regjistrimit dhe raportimit të të hyrave si dhe të siguroj që paratë e grumbulluara në arka depozitohen me kohë sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.	Po		
	Kryetari i komunës duhet të siguroj të bëhet edhe procesi i verifikimit të pronave komunale, siç parashihet me ligj si dhe duhet të siguroj se me rastin e aplikimit të koeficienteve të cilësisë së ndërtimit, kërkesat ligjore zbatohen me konsistencë për të shmangur mundësinë e zvogëlimit apo rritjes së pa drejtë të ngarkesave tatimore.			Nuk janë marrë masa.
	Kryetari duhet t'i rishikoj kontrollet mbi menaxhimin e procesit të të hyrave nga ofiqaritë dhe të vendos kontrollet e duhura me qëllim të parandalimit të mundësisë për keqpërdorime. Barazimi i gjendjes së formularëve të lëshuar nga ofiqaritë dhe shuma e taksave të mbledhura duhet të bëhet në baza të rregullta dhe diferencat eventuale duhet të sqarohen.	Është zbatuar		
	Kryetari duhet të siguroj që lejet ndërtimore lëshohen vetëm atëherë kur taksat ndërtimore është inkasuar në tërësi si dhe të sigurojë që lejet ndërtimore shqyrtohen brenda afateve ligjore.	Po		
3.1.3 Mallrat e Shërbimet, si dhe shërbimet komunale	Kryetari duhet të siguroj se mbajtja e tatimeve në burim për personat e angazhuar me kontrata për shërbime të veçanta bëhet në harmoni me legjislacionin e aplikueshëm në fuqi.	Po		

	Kryetari duhet të siguroj se janë shtuar kontrollet dhe janë marrë të gjitha masat për të parandaluar përsëritjen e mangësive të tilla. Më tej, duhet të siguroj se të gjitha procedurat, kontratat dhe pagesat bëhen në pajtim me ligjet në fuqi dhe arsyetojnë rregullsinë e shpenzimeve të parasë.	Po		
3.1.4 Subvencione dhe Transfere	Kryetari duhet të hartoj një rregullore për subvencione dhe të aprovohet në kuvend, e cila do të specifikonte qartë kriteret dhe procedurat për subvencionim.	Po		
3.1.5 Investimet kapitale	Kryetari duhet të forcoj kontrollet buxhetore, dhe me rastin e planifikimit, të siguroj se në planin e prokurimit janë përfshirë të gjitha kontratat që do të zhvillohen brenda vitit, dhe për të njëjtat fondet buxhetore janë të sigurta.		Ende ka dobësi në planifikimin e prokurimeve.	
	Kryetari duhet të siguroj se me rastin e pagesave të situacioneve të ardhshme për projektet në vazhdim si dhe projektet e reja, të aplikohet libri ndërtimor. Menaxherëve të projekteve tu qartësohet se aktivitetet e ardhshme duhet të jenë në pajtim me ligjin e ndërtimit (Ligji Nr. 04/L - 110) si dhe (UA 15/2013 i MMPH mbi kushtet për mbajtjen e ditarit dhe librit ndërtimor).	Po		
3.2 Pasuritë	Kryetari duhet të siguroj se është formuar komisioni i inventarizimit, dhe se në regjistrin e pasurisë nën 1,000€ janë të përfshira të gjitha blerjet në mënyrë që regjistri i pasurive të jetë i plotë dhe i saktë.		Është bërë inventarizimi, por mangësi janë hasur në regjistrim të pasurisë.	
	Kryetari duhet të siguroj se janë vendosur kontrole shtesë për shfrytëzimin e automjeteve për të siguruar llogaridhënie adekuate nga secili përdorues i automjeteve dhe për të evituar përdorimin jo të rregullt të tyre.			Nuk janë marrë masa.

3.2.2 Të arkëtueshmet	Kryetari duhet të vendos kontrole më efektive, për të siguruar se gjendja e llogarive është saktësisht e konfirmuar dhe nuk përmban gabime që do të rezultinin me nënpagesa/ mbipagesa të debitorëve.	Po		
3.3 Obligimet	Kryetari duhet të shqyrtoj në mënyrë kritike gjendjen e detyrimeve të papaguara, për të përcaktuar masat e nevojshme për adresimin e çështjeve të identifikuarra, dhe pagesat të bëhen në kuadër të limiteve kohore të përcaktuara me rregullat financiare, për të evituar rrethanat të cilat mund shkaktojnë pagesën e tyre drejtpërdrejt nga MF apo përmes vendimeve gjyqësore.		Edhe këtë vit ka pasur pagesa përmes vendimeve gjyqësore, por niveli i borxheve është përgjysmuar në krahasim me vitin e kaluar.	

Shtojca III: Letër konfirmimi



REPUBLIKA E KOSOVËS


REPUBLIC OF KOSOVA

REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT

MUNICIPALITY OF DECAN

OPSTINA DECANI



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2017 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit/Pasqyrave Financiare të Komunës së Deçanit , për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

z. **Bashkim Ramosaj**

Kryetar i Komunës,

Data: xx.Maj.2018, Deçan,

